



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1770/6 Prot.

Tiranë, më 17.07.2025

VENDIM

Nr. 41 Datë 17.07 2025

“PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT ME NR 67
DATË 29.09.2023 “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR POZICIONET E
PUNËS, NË ADMINISTRATË””

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015. "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë", neni 49 pika.1 gërma f, neni 67, pika 3; në Statutin e UST-së, kreu V, neni 50; në Rregulloren e UST-së, në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 "Për disa shtesa në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të ndryshuar, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17.07.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të pikës “ **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e vecanta si vijon:**” të Vendimkit të Bordit të Administrimit nr 67 datë 29.09.2023, si mëposhtë vijon nga si ishte në si bëhet ndryshimi.

Ishte:

- Arsimi: Kandidati që konkuron në pozicionin e punës duhet të zotërojë së paku diplomë të nivelit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të në fushën e drejtësisë ose ekonomikut.
Përvoja: Të kete përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion.
Tjetër: Njohuri të legjislacionit dhe procedurave të tjera administrative e juridike, njohuri në prokurimet publike.

Bëhet:

- Arsimi: Kandidati që konkuron në pozicionin e punës duhet të zotërojë së paku diplomë Master Profesional në fushën e drejtësisë ose ekonomikut.
Përvoja: Të kete përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion.
Tjetër: Njohuri të legjislacionit dhe procedurave të tjera administrative e juridike, njohuri në prokurimet publike.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Prot, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, të Universitetit të Sporteve të Tiranës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

